

Nga Namik SELMANI

“REÇAKU” I ÇAMËRISË

- Në kujtim të përvjetorit të Masakrës së Selanit në Çamëri -

Ah, Reçaku! Për shumë e shumë kohë, por edhe për breza të tërë, emri i Reçakut të Kosovës do të kujtohet i shoqëruar me një ofshamë të madhe, me një eho shpirti në kujtim të atyre njerëzve, kryesisht burra dhe fëmijë, në pranverën e Kosovës të etur për liri. Do të ishin therorët e fundit të saj. Edhe unë, ashtu si gjithë vëllezërit kosovarë dhe mbarë shqiptarët kudo ku jetojnë dhe shkruajnë historinë e tyre të re mbi gjurmët e pashlyera të së kaluarës, e ndiej nga aq pranë dhimbjen aq të madhe të vrasjes e të masakrës që bënë pushtuesit serbë në prag të fundit të pushtimit të tyre në Kosovë në 15 janar të vitit 1999 në Reçak të komunës së Shtimjes të Kosovës. Fshati i vogël i Reçakut në Kosovë ndoshta do të mbetej për shumë kohë i heshtur, jo dhe aq i njohur në mjediset europiane, gati i panjohur në anonimatin e vet, po të mos kishte ndodhur ajo ngjarje e madhe tragjike që shënon edhe pikën e madhe të kthesës së diplomacisë europiane e botërore që deri në atë kohë ende nuk e kishte thënë fjalën e vet vendimtare për Kosovën që po përgjakej dita-ditës nga dora gjakatare serbe. Një ditë më pas, në këtë vend shkoi vetë ambasadori amerikan Uiliam Uolker. Para kësaj tragjedie, ai do të thoshte: “Kjo është ngjarja më e trishtuar e jetës sime. Ky është një krim i vërtetë kundër njerëzimit.”

E m’u sollën në përfytyrimin tim ato 45 vetë, në mes të të cilëve pleq, fëmijë të pafajshëm dhe një grua, që u vranë në mënyrën më mizore. Është po kaq e dhimbshme të krijosh paralelizma kaq të spikatur në historinë e këtyre dy krahinave që padrejtësisht u copëtuan nga trungu i Shqipërisë amë, duke krijuar të ashtuquajturën Shqipëri Londineze.

Në këtë kujtesë të gjaktë të vëllezërve nga Kosova në prag të lirisë së saj në fund të shekullit XX në mes të Evropës, më erdhi në mendje ajo ngjarje me përmasa edhe më të mëdha, edhe më

gjakatare që në fillim të shekullit XX do të gjendej një nga faqet më tragjike të popullsisë së Çamërisë e të mbarë kombit shqiptar.

Për rastësi, masakra e pashembullt me 72 burra sojlinj, si i thonë në Çamëri, ndodhi në Selan që ishte afër Paramithisë.

Për fatin e keq të 72 burrave më të mirë e më të zgjedhur të kësaj krahine, kjo ndodhte në vitin 1913, kur mungonin mjetet e komunikimit që Ballkani e mbarë Europa të merrte vesh se çfarë kishte ndodhur.

Ashtu si ndodh rëndom në këto raste aspak të lakmueshme për një fshat, për një vend, në kujtesën individuale dhe kolektive për një komb këtë mision e mori kënga popullore. Kënga popullore çame e dalluar për lirizmin e saj të hollë, për këngët e dashurisë, për ninullat e ëmbla, ashtu si edhe vallja e saj shumë e bukur ka pak këngë epike e mund të themi se për nga përmasat e dhimbjes dhe të revoltës, të urrejtjes ndaj një krimi barbar kaq masiv, të bënte edhe një detyrë të tillë fisnike. Do ta bënte këtë gjë edhe Reçaku në fund të shekullit me vargje, me këngë të dhimbshme, me kukama motrash e nënash. Ja si shkruhet në një nga këngët e Çamërisë për tragjedinë e Selanit:

“Ç’ më dridhet kjo dora/që s’ më shkruan mirë/pse nuk shkruan gjëmën/që zu Çamërinë/Dora, o më dridhet/më dridhet shumë/dhe lotët e sivet/më derdhen si lumë/mu në mes të natës / I muarr i shpunë /manastir Curril/I therën i grinë/grekërit barabarë/me shqelbe i shtipnë...”

Vështirë që të gjesh këngë popullore të krahinës së Çamërisë që të ketë këto përmasa të dhimbjes njerëzore. Në një këngë të krijuar në Filat të Çamërisë dhe që studiuesi i njohur i folklorit çam Fatos Mero Rrapaj e ka gjetur në vitin 1955, rreshtohen gati të gjithë ata që u bënë theror i mëmëdheut të tyre që këndeje e tutje do të lëngonte në thundrën e pushtuesit grek. Bashkë me këta heronj të vërtetë të lirisë së Çamërisë, kënga mori përsipër që të vinte përballë ata që e projektuan dhe e ekzekutuan këtë krim barbar duke nisur nga barbari grek Delijanaqi.

Ngjarja e viti 1913, që do të quhej nga historianët e Çamërisë dhe nga folklori i kësaj krahine “Masakra e Selanit”, kishte një sfond historik aspak të favorshëm për popullsinë çame e aq më

tepër edhe për shtetin e ri shqiptar që ishte krijuar vetëm para pak muajsh, më 1912 duke lënë jashtë kufijve të kombit shqiptar me mijëra e mijëra kilometra katrorë e një popullsi shumë të madhe duke përfshirë Kosovën në Veri e Çamërinë në Jug të saj. Shteti grek, i përgatitur për këtë fitore të madhe politike e diplomatike, kishte përgatitur skenarë nga më të egrit mbi popullsinë e pambrojtur të Çamërisë që tani e tuje do të ishte në oborrin e një shteti që asnjëherë nuk ua kishte dashur të mirën dhe që asnjëherë nuk ua kishte përkrahur identitetin e tyre kombëtar, fetar, kulturor, aq më shumë atë gjuhësor.

Para se të shpallej Pavarësia e Shqipërisë, në tokat e Çamërisë kishte shumë luftëtarë shqiptarë që kundërshtonin pushtimin e ri, kësaj radhe edhe i bekuar me shkresat e diplomatëve evropianë. Ky kundërshtim tregojë në luftën me armë në dorë kundër ushtrisë greke që shumë më tepër se në vitet e mëparshme e shihte këtë tokë tamam si çifligun e tyre. Ishte dhënë një urdhër i prerë nga princi Kostandin që nga toka e nga deti të pushtojë Çamëria e të gjunjëzojë populli i saj. Në këto forca shqiptare kishte edhe shumë vullnetarë nga Fieri, Tepelena, Mallakastra, nga Labëria e nga krahina të tjera të Jugut të Shqipërisë. Frika se mos mbyllet kufiri administrativ i Greqisë, bëri që disa luftëtarë të ardhur nga këto krahina të largoheshin. Megjithatë lufta u vazhdu nga të tjerë luftëtarë çamë të udhëhequr nga Abedin pashë Dino nga Preveza, nga Ali Riza Pashaj, nga Muharrem Rushiti nga Koska, Qemal Frashëri nga Filipadha, Zija Dojaka nga Filati etj.

Pa ndihma ushtarake dhe politike, edhe pse luftuan deri në kafshatën e fundit, forcat shqiptare nuk mundën që të vazhdonin më tej. Kështu që më 21 shkurt 1913, sipas edhe historianit Beqir Meta, grekët arritën që ta marrin Janinën. Një fitore e shumëpritur nga ata, por jo e fundit. Të tjera plane po thureshin në kancelaritë e Greqisë. Në këtë kohë, ata thirrën në ndihmë edhe dinakërinë e tyre që ka qenë arma rezervë, kur ka munguar forca e ndeshjes ballore. Me një lloj maturie dredharake tërë dinakëri, ajo u fut pa luftë në fshatrat çame duke krijuar edhe postkomandat e tyre në to. Me kujdes të madh ata nisën që të vrisnin të gjithë luftëtarët që bënë rezistencën e para disa muajve. Veçse kjo gjë tani po bëhet me një fshehtësi të plotë dhe në mënyrë shumë misterioze. Në këtë betejë, tashmë pak sa të heshtur, po jo më pak vrastare se e mëparshmeja,

kishte një rol të madh edhe feja. Priftërinjtë ortodoksë, që ishin pothuaj në çdo fshat të Çamërisë po luanin rolin më të keq që mund të luajë një njeri i besimit në një vend që kishte po kaq besimtarë të devotshëm të fesë muslimane si ishte pjesa më e madhe e popullsisë së Çamërisë. Dokumentet e kohës tregojnë për një ankesë të madhe që bënë familjet muslimane çame për shumë djem që ende ishin robër, ishin burgosur apo ishin syrgjynosur në vende të tjera të panjohura dhe nuk dihej se ku ishin. Brenda disa ditësh, delegacioni i çamëve, me në krye Mehmet Konicën, takoi Z. Norsan dhe e vuri në dijeni për këtë shqetësim të banorëve. Por edhe këto ankesa po vinin në vesh të shurdhër. Edhe më 1947, kur ishin dy-tre vjet që kishin përfunduar të tjera masakra edhe më masive kundër popullsisë muslimane të Çamërisë dhe dëbimit të tyre me forcë nga trojet stërgjyshore me qëllim pastrimin e trojeve amtare, Komiteti Antifashist i Emigrantëve Çamë i dërgoi një letër të hapur Këshillit të Sigurimit në OKB ku, ndër të tjera, i kujton edhe këtë masakër. Ata e quajnë atë si një thyerje të plotë të gjithë traktateve ndërkombëtare dhe humanitare.

Dhe erdhi dita e madhe e dhimbjes. Dita e masakrës. Dita e gjenocidit më të madh që ka shkaktuar qeveria greke në një ditë të vetme. Një masakër që do të përsëritej po me këtë forcë edhe pas 30 viteve më vonë. Për ironi, në të njëjtin vend si Paramithia.

Përpara tyre ishte plani ogurzi që të zhdukeshin krerët më të spikatur të fshatrave çame. Në realizimin e këtij plani famëkeq do të thirreshin nën armë të paktën 200 andartë grekë, shumica e të cilëve ishin kriminelë ordinerë që ishin nxjerrë me qëllim nga burgjet greke apo edhe të grumbulluar në mënyrë mercenare nga fshatrat ortodokse greke. Kjo ndodhi në datën 27 mars 1913. Në dritën e hënës, që të kujtonte se në bregoret e Çamërisë po vinte pranvera, të 200 andartët grekë u vërsulën në fshatrat çame. I kishin të shënuar të gjithë emrat e atyre që do t'i vinin në një gijotinë të egër. Në grupin e parë ishin ata që shkonin në fshatrat Nihuar, Rrëzanj, Beden, Koriqan, Skupicë, Dramës. Pas trokitjes në portë, ata u thonin: "Vishuni bukur, se ju kërkon qeveria. Do të merrni emërimin si kryeplak ose ndonjë emërim tjetër."

Porsa dilnin te dera të veshur bukur, andartët u lidhnin fort

duart me tela dhe i merrnin me vete. Në Mininë u arrestuan 13 vetë: Xhemal Ademi, Veli Murati, Vesel Balo, Nuh Nuhu, etj. Në Nihuar u morën 10 vetë, si: Bejaz Selimi, Adem Shehu, Duro Dauti, Gafur Qemali etj. Në Koriqan u morën dy djem të mirë: Mehmet Maza dhe Shauip Meta. Në Dramës u morën 10 vetë. Kështu vargu i burrave më të mirë, më të shkolluar dhe më patriotë të këtyre fshatrave shkoi në 73 vetë. Në kohën që ashtu, të lidhur mirë e në kërcënimin e bajonetave të pushkëve të tyre, andartët i nisën për në Paramithi. Si fillim, të lidhur dy nga dy, i vendosën në shtëpinë e Kushenjve, që kishte një avlli të lartë. Para se të niseshin, një djalë 21-vjeçar i quajtur Vejsel Rexho, pasi zgjidhi duart nga duart e shokut të tij, u hodh nga avllia. Avllia ishte shumë e lartë e kërkonte një guxim të madh. Në breshërinë e pushkëve të panumërta të andartëve, ai u largua dhe i shpëtoi i vetëm lukunisë greke që do të ishte shumë tragjike për ata që mbetën aty. Të 72 burrat u nisën për në Paramithi. Vetëm para pak kohësh, pikërisht aty grekët kishin thurur planet për këtë masakër e po aty kërkonin që të bënin realitet. Te Rapi i Kushes u ndalën nga një grup i Komandës së Garnizoni prej 5 vetash, që i dhanë një letër sekret komandantit të kësaj masakre, Delijanaqit. Ishte një letër që vinte direkt nga komandanti i garnizonit të Paramithisë, Kol Dhimitraqi. Me të marrë letrën, Delijanaqi urdhëroi që burrat të drejtoheshin në një grykë përroi ku do të eliminoheshin që të gjithë. Rruga po i çonte nga Përroi i Selanit ku edhe krismat e pushkëve mund të dëgjoheshin sa më pak. Të gjithë të lidhurit e kuptuan këtë dredhi, ndaj edhe filluan të kundërshtonin, por bajonetat që i shponin egërsisht në trupa, bënë që ata të ecnin. Njëri prej tyre, Dalan Binozi, u thotë andartëve: “Ne e kuptuam se ju po na çoni për të na vrarë, por dijeni se Çamërisë nuk do t’i mungojnë burrat edhe pas vrasjes sonë”. Shkopinjtë e panumërt që u binin në kokë, kishin filluar të afronin masakrën e madhe. Tani nuk kishte më asnjë mëdyshje, pasi ata i priste vdekja e sigurt. Në kohën kur i futën në një grykë të ngushtë të Selanit, u dha urdhri: “Zjarr!” Britmat e burrave që po shpoheshin nga plumbat, nisën të ndiheshin aq fort. Gjysma e burrave ra menjëherë të shtrirë nga plumbat, ndërsa të tjerë po goditeshin me sëpata e me kondakë të pushkëve. Aty ku dëgjohej ndonjë rënkim, goditjet ishin edhe më të forta.

Ende pa u dalë shpirti, andartët nxituan që merrnin çdo gjë të vlefshme që burrat kishin në duar apo në xhepa: orë, unaza, para. Me ditë të tëra dëgjoreshin rënkime të burrave gjysmë të vrarë e që po jetonin një vdekje të dytë. Ishin burrat më “delikalli,” si thotë një këngë tjetër për ta. Ajo varrezë masive, që nuk u mbulua kurrë, ishte turpi më i madh i Greqisë në atë pranverë të përgjakur të Çamërisë...Kjo revoltë njerëzore dhe me përmasa të mëdha kombëtare u shpreh edhe në një këngë tjetër “Trembëdhjetë, vit i shkretë/njam në qiell u ngrenë retë/Venizellua me mbrenë / dojën, therën vranë e prenë/Çamëria me gjak të mbitnë /Evropa pastë lanenë /zëmra mos t’u lëshojë/mbloi zija në Çamëri/u vë vendi shkumb e hi...”

Ngjarja e marsit të vitit 1913 pati një jehonë të madhe në qarqet diplomatike. Në arkivin politik të Vjenës për Shqipërinë është një raport i gjatë i konsullit austriak në Janinë për ministrin e Jashtëm austriak March ku tregohet e vërteta përpara gënjeshtres diplomatike që sajonte qeveria greke. E vendosur përpara një fakti shumë kokëfortë, në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës, përfaqësuesi grek u mundua që të mashtronte opinionin diplomatik dhe atë european se gjoja “për veprat e kryera nga bandat kryengritëse të andartëve nuk ishte përgjegjëse qeveria greke”. Vetë diplomati austriak thotë në raportin e tij se “këto banda ishin rekrutuar nga qeveria greke dhe komandoheshin nga forca të rregullta greke”.

Masakra të tilla ishin planifikuar edhe në Gumenicë, Filat e gjetkë, por jehona e Masakrës së Selanit bëri që të gjendeshin forma të tjera më dinake për të zhdukur bijtë më të mirë të Çamërisë. Kënga popullore çame, e krijuar në Kastri të Gumenicës, tregon për një çam që quhej Nasho Ligori nga Shulashi që, i armatosur deri në dhëmbë, takoi ballë për ballë Deli Janaqin që kishte drejtuar Masakrën dhe e kërcënoi atë me jetë, nëse ai do të vazhdonte me masakra të tilla në Gumenicë.

E kujtesa popullore kësaj radhe ka jo vetëm kujtimin tragjik të kësaj Masakre, por edhe një mesazh të madh të nderimit për këta burra heronj të lirisë së Çamërisë që po e vriste që në hapat e saj të parë qeveria greke. “Shqiptarët gjithë sa jini/amanetin t’e kini/therie e vraslat t’i këjtoni/grekut mos ja harroni/të këqijat

që na bënë /I pa dunjaja e tërë/ sa të rroni e sa të ini/Çamërinë në mend ta kini...”

Duke kujtuar sërish Reçakun e përgjakur të para disa viteve në Kosovë, në një janar të ftohtë e të borëruar, të duket se këto masakra që janë bërë ndaj kombit tonë, ishin një parathënie e një gjenocidi që fqinjët grekë, e më vonë ata serbë, kanë bërë ndaj kombit tonë në vitet kur historia jonë ka jetuar udhëkryqet e saj më të dukshme, më të rëndësishme. Pas deklaratës që bëri ambasadori amerikan në Reçak, shumë fotografë, kameramanë e reporterë të medias vrapuan të fiksonin me të gjitha mjetet e mundshme këtë masakër, por për Masakrën e Selanit nuk u bë ky sensibilizim. Jo vetëm që nuk kishte mjete të tilla të medias, por andartët e qeveria greke as që mund të lejonin të bëhej një gjë e tillë. Madje edhe sot, pas gati 100 vjetësh, në të nuk ka asnjë pllakë përkujtimore, pale një Monument të Dhimbjes njerëzore për njerëz që kishin një emër, një vitlindje, një fshat prej nga u nisën dhe një varr të panjohur për njerëzit e tyre të afërt. Për fat të keq, edhe në rrethet e atyre që përfaqësojnë të drejtat e çamëve, nuk është bërë një veprimtari e gjerë përkujtimore për ta. Ndoshta këtë gjë në një formë të ndryshme mund ta bënte edhe komuniteti musliman shqiptar. Tashmë është plotësisht e njohur që masakra ndaj tyre kishte edhe karakter fetar, aq më shumë që në anën e masakruesve u vunë edhe klerikë të fesë ortodokse greke.

Ah, Reçaku! Themi ende, kur e kujtojmë atë masakër dhe, pak më vonë, kur kujtojmë lirinë e Kosovës, të ardhur mes sa e sa sakrificash. Bashkë me të, kur kujtojmë historinë tragjike të Çamërisë, na duhet të themi për të po me kaq dhimbje të madhe njerëzore: “Ah, Selani!”

Literatura e shfrytëzuar

1. Beqir Meta - Tragjedia çame.
2. Fatos Mero Rapaj - “Rënkimet e Çamërisë”.
3. Ibrahim Daut Hoxha - “Bilibila e thëllëza çame”.
4. Ibrahim Daut Hoxha - “Çamëria dhe Janina”.
5. Fatos Mero Rrapaj - “Fjalori onomastik i Çamërisë”.
6. Nuri Dragoi - “Shqiptarët e grekët”.
7. Avdi Begati - “95-vjetori i Masakrës së Selanit” - “ Çamëria” - 27 mars 2008.